PSH.nr.947/20

953/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "Çeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë, dhe OE: "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: "Pro & Co Group"SH.P.K : "Florin G"SH.P.K-Kllokot, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi dhe mirëmbajtje e objekteve të Gjykatave dhe SKGJK-së" , me nr. të prok 328-20-4309-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Këshilli Gjyqësor i Kosovës", më datën: 18.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: "Çeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë, dhe ankesa e operatorit ekonomik: "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë, kundër njoftimit mbi dhënie te kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi dhe mirëmbajtje e objekteve të Gjykatave dhe SKGJK-së" , me nr. të prok 328-20-4309-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Këshilli Gjyqësor i Kosovës" .

II.ANULOHET, njoftimi per dhënie te kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi dhe mirëmbajtje e objekteve të Gjykatave dhe SKGJK-së" , me nr. të prok 328-20-4309-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Këshilli Gjyqësor i Kosovës" , dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/

L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Qeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë, dhe operatorit ekonomik ankues: "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë, aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues Çeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë dhe operatori ekonomik ankues: "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: "Qeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë, dhe OE: "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr. 947/20 ,dhe me 16.11.2020 me nr. 953/20 , kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e

prokurimit me titull: "Riparimi dhe mirëmbajtje e objekteve të Gjykatave dhe SKGJK-së" , me nr. të prok 328-20-4309-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Këshilli Gjyqësor i Kosovës", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 7 , 59 , 60 , 61 , si dhe nenin 64 të LPP-së , te ankesa me nr. 947/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 59 , 60 , 64 , 52 , 61 , si dhe nenin 72 të LPP-së, te ankesa me nr. 953/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Qeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë,

Eksperti Shqyrtues konsideron se Autoritetit Kontraktues – Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ne Njoftimi për Kontrate dhe ne Dosje te Tenderit nuk e ka specifikuar Çmimin e parashikuar te Poentimit "Tavanin e Poentimit" por vetëm si Kontrate Kornizë me çmimin e parashikuar te realizimit te punëve 499,999.00 € për 36 muaj, andaj nuk ka një bazë te saktë referuese te çmimeve te ofruara. Sa i përket pretendimit te OE ankues – Grup i OE "Çeta-General Invest Group" sh.p.k & "Blenor" sh.p.k:, ne lidhje me arsyen e eliminimit për Çmimet Jo-Normalisht te Ulëta, sidomos për pozicionin nr. 62, krahasimit te çmimeve te tija me OE te rekomanduar dhe arsyeve te eliminimit

ARSYETIM
Ju nuk keni ofruar dëshmi, sipas LLP, neni 61 Tenderet Jo-Normalisht të Ulët, kërkesës-Letër Standarde, për secilin pozicion. Përkatësisht, ju mungojnë dëshmitë për pozicionet:

	TABELA IV	Njësia Matëse	Njësi	Çmimi për njësi (me TVSh)
62	Furnizimi dhe montim Tabela modulare tip VDI 19"-42U e kompletuar me te gjitha pjesët përcjellës për te formuar rrjetin e PC-se dhe telefonit. Çmimi komplet **Për këtë pozicion mungon dëshmia bindëse, e ofruar nga ana e juaj. Përshkrimi nuk korrespondon me kërkesën.- listën e çmimeve**	Komplet	1	250.00
122	Furnizimi dhe montim ore matës 5/4"	copë	1	85.00
123	Furnizimi dhe montim ore matës 6/4"	copë	1	100.00

Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar dhe AK është dashur qe ti marre parasysh sqarimet e dhëna nga OE ankues, ku dëshmohet se për pozicionin nr. 62 çmimi i ofruar nga OE ankues është 250,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 50.00 €.

Si mund te konsiderohet Çmim Jo-Normalisht Ulët 250 euro për poz. 62, ndërsa te rekomandohet për dhënie te kontratës OE me çmimin 50 euro për te njëjtin pozicion. Gjithashtu OE ankues duke i krahasuar çmimet e tija me OE te rekomanduar për pozicionet nr. 119, 120, 121, 122, 123, 124, shihet se ne këto pozicione ka çmime me te larta se sa OE i rekomanduar: Për pozicionin nr. 121 çmimi i OE ankues është 55,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 30.00 €. Për pozicionin nr. 122 çmimi i OE ankues është 85,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 30.00 €. Për pozicionin nr. 123 çmimi i OE ankues është 100,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 30.00 €. Për pozicionin nr. 124 çmimi i OE ankues është 120,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 30.00 €. Oferta e OE ankues - Konsorciumi "Çeta-General Invest Group" sh.p.k & "Blenor" sh.p.k:

	TABELA IV	Njësia Matëse	Njësi	Çmimi për njësi (me TVSh)
62	Furnizimi dhe montim Tabela modulare tip VDI 19"-42U e kompletuar me te gjitha pjesët përcjellëse për te formuar rrjetin e PC-se dhe telefonit, Çmimi komplet	komplet	1	250.00
119	Furnizimi dhe montim orë matësi 1/2"	copë	1	20.00
120	Furnizimi dhe montim orë matës 3/4"	copë	1	35.00
121	Furnizimi dhe montim orë matës 1"	copë	1	55.00
122	Furnizimi dhe montim orë matës 5/4"	copë	1	85.00
123	Furnizimi dhe montim orë matës 6/4"	copë	1	100.00
124	Furnizimi dhe montim orë matës 2"	copë	1	120.00

Oferta e OE te rekomanduar – Grup i Operatoreve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; Florin G SH.P.K

119	Furnizimi dhe montim orë matësi 1/2"	copë	1	16.95	3.05	20.00
120	Furnizimi dhe montim orë matës 3/4"	copë	1	16.95	3.05	20.00
121	Furnizimi dhe montim orë matës 1"	copë	1	25.42	4.58	30.00
122	Furnizimi dhe montim orë matës 5/4"	copë	1	25.42	4.58	30.00
123	Furnizimi dhe montim orë matës 6/4"	copë	1	25.42	4.58	30.00
124	Furnizimi dhe montim orë matës 2"	copë	1	25.42	4.58	30.00
125	Furnizimi dhe montim hidrantë i brendshëm Ø50	copë	1	84.75	15.25	100.00

OE ankues – Grup i OE "Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor" shpk: ne sqarimet e dhëna për AK ka dëshmuar deklaratën e kërkuar te nënshkruar dhe vulosur duke zbërthyer te gjitha pozicionet e lartcekura, si dhe për dëshmi ka ofruar faturat e kërkuara ku dëshmohet arsyeshmëria e çmimeve te ofruara

ÇETA - GENERAL INVEST GROUP SH.P.K
Rr."Nëna Terezë" Nr:158, 12000 Fushë Kosovë, Kosovë
Tel+Fax: +381 (0)38 544380, Mob. +377 (0) 44-504101, 232167, 394853
E-Mail: ceta_gig@hotmail.com, www.ceta-gig.com

Titulli i kontrates:
Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve te gjykatave dhe SKGJK-se
Nr.prok. **33300/20/021/521**
Autoriteti kontraktues:
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Lënda:
Sqarim i pozicioneve me çmimin jo-normalisht të ulët

DEKLARATA

Nr.	TABELA IV	Njësia Matëse	Njësi	Çmimi për njesi (me TVSH)	Arsyetimi
62.	Furnizimi dhe montimi Tabela modulare tip VDI 19"-42U e kompletuar me të gjitha pjesët përcjellëse për të formuar rrjetin e PC-së dhe telefonit , Çmimi komplet	komplet	1	250.00€	Në bazë të këtij përshkrimi ne produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.81/5 ,çmimin me TVSH 200€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
119.	Furnizim dhe montim orë matësi 1/2"	copë	1	20.00€	Në bazë të këtij përshkrimi ne produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 12.35€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
120.	Furnizimi dhe montim orë matësi 3/4"	copë	1	35.00€	Në bazë të këtij përshkrimi ne produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 18.91€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
121.	Furnizimi dhe montim orë matësi 1"	copë	1	55.00€	Në bazë të këtij përshkrimi ne produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 139.90€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
122.	Furnizimi dhe montim orë	copë	1	85.00€	Në bazë të këtij përshkrimi ne produktin e kemi sigurar në

ÇETA GENERAL INVEST GROUP SH.P.K DESIGN & CONSTRUCTION

ÇETA - GENERAL INVEST GROUP SH.P.K
Rr."Nëna Terezë" Nr.158, 12000 Fushë Kosovë, Kosovë
Tel+Fax: +381 (0)38 544380, Mob. +377 (0) 44-504101, 232167, 394853
E-Mail: ceta_gig@hotmail.com, www.ceta-gig.com

	matësi 5/4"				treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 50.35€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
123.	Furnizimi dhe montim orë matësi 6/4"	copë	1	100.00€	Në bazë të këtij përshkrimi na produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 76.00€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
124.	Furnizimi dhe montim orë matësi 2"	copë	1	120.00€	Në bazë të këtij përshkrimi na produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me f Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.769 ,çmimin me TVSH 104.50€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë
127.	Furnizimi dhe montimi hidrantë i jashtëm Ø50	copë	1	85.00€	Në bazë të këtij përshkrimi na produktin e kemi sigurar në treg të cilin e dëshmojmë edhe me Profaturë/Ofertë e furnizimit me nr.20-PSV01-ALB-26 ,çmimin me TVSH 65.00€ , montimin e bëjmë me punëtorët tanë

Bashkangjitur i gjeni edhe dëshmit e Profaturave të ofruara nga Furnitorët në tregun kosovar.

Shërbimet e furnizimit dhe montimit janë në llogari të kompanisë pasi jemi të specializuar për kryerjen e këtyre shërbimeve. Ne posedojmë staf të mjaftueshëm të cilët paghen në baza mujore për shërbimet që kërkohen nga Kompania.

Ne bashkaraisht si dy kompani qëndrojmë prapa kësaj oferte dhe pajtohemi me çmimet e ofruara.

Përfaqësuesi i Grupit të konsorciumit
"Çeta-Ghereal Invest Group" SHPK

Ing.Dipl. Musar Kabashi
Menaxher i Kompanisë
Data: 20 Tetor 2020

WIRKOS

Nr. 16-Oct

Oferte

Fushë Kosovë, Kosovë

Blerësi	
Emri	Blenor SHPK
Adresa	
Qyteti	Istog
Nrb	811224005

Llogaria	
Datë	10/16/2020
Nr.i porosisë	81/5
Nr.Fiskal	K97005004V

Sasia	Modeli		Me TVSH
1	Rack 600X600X42U 19"	200.00 €	200.00 €

TOTAL	200.00 €

Pagesa

Nr i Llogarisë	
Në Bankën	
Vendi	
Pranoi Faturën	
Nënshkrimi	

Pranoi:

N.T.SH. EDONI COM
Tel./Fax. 038 353 226

Nr. Ikdak: 600049060
Nr. biznesit: 80317344
Nr. Tvsh: 330080179
Adresa: Zona Industriale Fushë Kosovë

Bleresi

BLENOR SH.P.K.

Adresa: Istog, 31000, Smajl Bicaj nr.49
NRB: 71017958
NRFIS: 601054927
NRTVSH: 330217994

OFERTE Nr. : 769

Afati: 0 Ditë

Agjenti:

Data: 16/10/2020

#	Shifra	Artikulli	Njesia	Sasia	CmPaTvsh	CmBruto	Lirim%	Tvsh%	Cmimi	VlMeTvsh
1	3448	Ore uji xhakomin 1/2	Copë	1.00	11.02	13.00	5.00	18	12.35	12.35
2	6611	Ore uji Klepsan 3/4" KVS-5K	Copë	1.00	16.86	19.90	5.00	18	18.91	18.91
3	6612	Ore uji Klepsan 1" KVS-16K	Copë	1.00	35.59	42.00	5.00	18	39.90	39.90
4	6613	Ore uji Klepsan 1 - 1/4" KVS-17K	Copë	1.00	44.92	53.00	5.00	18	50.35	50.35
5	6614	Ore uji Klepsan 1 - 1/2" KVS-18K	Copë	1.00	67.80	80.00	5.00	18	76.00	76.00
6	6615	Ore uji Klepsan 2" KVS-19K	Copë	1.00	93.22	110.00	5.00	18	104.50	104.50

Vlera Bruto :	317.90	Baza 0%:	0.00	Vlera pa tvsh:	255.94
Lirimi :	15.90	Baza 8%:	0.00	Tvsh:	46.07
		Baza 18%:	255.94	Vlera me tvsh:	302.01

Procredit Bank: 1189000933010129
Teb Bank: 2014000154465794
Nlb Bank: 1701017600043770

Ofertoi:

Pranoi:

ALBKOS SAFETY SH.P.K.
Rruga e Pejës nr. 26
12000 Fushë Kosovë
Republika e Kosovës

NUI 811440900 | TVSH 330455958

OFERTË / PROFATURË
Nr.: 20-PSVO1-ALB-26

Albkos Safety • Rr. e Pejës 26 • 12000 Fushë Kosovë • Republika e Kosovës

Të dhënat e klientit:

BLENOR SH.P.K.
NRF 601054927 | NUI 811224005
Sonaji Bicaj nr.49
32000 Istog
Tel.: 044 141 786

Data e faturimit	Kushtet e pagesës	Përpiloi	Referenca	Numri i faqeve
16.10.2020				1/1

Poz.	Nr. artikullit	Përshkrimi i artikullit / shërbimit	Sasia njësia	Çmimi/njësi pa TVSH	Zbr. [%]	TVSH [%]	Çmimi/njësi pas zbritjes	Gjithsej pas zbr. pa TVSH
1	0132095-2	Hidrant 2" (Fi=50mm)	1 copë	55.08	0.00	18.00	55.08	55.08

=	Gjithsej pa TVSH - para zbritjes [EUR]	55.08
-	Gjithsej zbritja [EUR]	0.00
=	Gjithsej pa TVSH - pas zbritjes [EUR]	55.08
+	Gjithsej TVSH [EUR]	9.92
=	Gjithsej me TVSH [EUR]	65.00

Afati i lëvrimit 16.10.2020
Kushtet e pagesës:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Arhiko-Ing" O.P – Prishtinë,

Fillimisht duhet te theksohet se ankesa e OE ankues është dorëzuar vetëm nga lideri "ARHIKO-ING" O.P ndërsa oferta është si konsorcium – Grup i Operatoreve Ekonomik "ARHIKO-ING" O.P ADRIATIKU – 1 SHPK. dhe askund ne ankese nuk i është referuar si grup i operatoreve ekonomik, andaj i rekomandoj bordit trajtimin e pranueshmërisë ose refuzimit te ankesës, për sa i përket aspektit administrativ. Sa i përket pretendimit Pika 1 te OE ankues "ARHIKO-ING" O.P ne lidhje me rekomandimin për dhënie te kontratës për Grup i Operatoreve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH.P.K. i cili ka ofruar Çmime Jo-Normalisht te Ulëta, për pozicionet konkrete te trajtuara nga OE ankues. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, dhe ne baze te krahasimeve te bëra dhe dëshmive te ofruara Grup i Operatoreve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH.P.K. ka ofertuar me çmime Jo-Normalisht te Ulëta. Për pozicionet nr 17 - Rampa me hapje elektronike me gjatësi 400 cm, sipas dëshmive (profaturave) nga IRFA dhe Arma Kontrol, te ofruara nga OE ankues me çmime 900.00 € respektivisht 950.00 €, dëshmohet se çmimi i ofruar 50.00 € nga OE i rekomanduar është Çmim Jo-Normalisht i Ulëta, por njëkohësisht edhe çmimi 70.80 € i OE ankues "ARHIKO-ING" O.P për këtë artikull është Çmim Jo-Normalisht i Ulët. Sa i

përket pretendimit te OE ankues: Pika 2: Ne pozicionin nr. 30 me përshkrim: "Ngjyrosja e murit me ngjyrë yndyrore në dy shtresa. (lloji i ngjyrës përcaktohet nga investitori)" është dhënë çmimi shume i larte 9.0 Euro ne krahasim me çmimin e tregut, kurse ne pozicionin nr. 32 me përshkrim "Furnizimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve me polikollor- ngjyrë në tri shtresa. (lloji i ngjyrës përcaktohet nga investitori)" ku pothuajse është i ngjashëm, çmimi është dhënë 1 Euro. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, duke marre parasysh krahasimet ne mes poz. 30 (9.0 euro) dhe poz. 32 (1 euro) te ofertës se OE te rekomanduar. OE i rekomanduar ka ofruar çmime jo reale, ka bere lëvizje artificiale ne mes çmimeve te ngjashme me qellim te përfitimit gjate ekzekutimit te kontratës. Një kontrate e tille është ekonomikisht e pa favorshme për AK. Sa i përket pretendimit te OE ankues: Pika 3: Pozicioni nr. 35 me përshkrimin: "Furnizimi, transportimi dhe punimi i fasadës "DEMIT" d=5cm me stiropor të presuar N4 ku si punim final është "fasadexi plastik", duke marre parasysh aplikimin e ngjitësit, stiroporit d=5cm, tipllave, rrjetës, ngjitësit dhe shtresës rrafshuese" ku është dhënë çmimi 5.00 Euro nuk e kemi te qarte si është e mundur te punohet me lire se sa pozicioni nr. 30 ku çmimi është 9.00 Euro . Kjo i bie qe çmimi ne poz. 53 është jo-normalisht i ulet dhe manipulues. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, duke marre parasysh krahasimet ne mes poz. 35 (5.0 euro) dhe poz. 30 (9.0 euro) te ofertës se OE te rekomanduar. E njëjta vlen edhe për pozicionet nr. 193 dhe 61, te kontestuara nga OE ankues ndaj OE te rekomanduar.

Sa i përket pretendimit te OE ankues - Pika 8: Përveç pikave te cekura me larte për pozicione te caktuara AK ka bere shkelje te nenit 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- paragrafi 4 sipas te cilit AK duhet te shpalle tenderin e përgjegjshëm nëse tenderi është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashkruara ne njoftimin e kontratës dhe dosjes se tenderit. Tenderi ynë i ka plotësuar te gjitha kërkesat e njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar, pasi qe ne baze te Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar, shihet qarte se për pozicionet e listuara nga AK, çmimet e ofertës se OE ankues janë Jo-Normalisht i Ulëta, ku vlen te veçohen pozicionet: 17 - Rampa me hapje elektronike, ku ka ofertuar me çmimin 70.8 € qe është çmim ekstrem i ulet. 19 - Sporteli i punës me pale, ku ka ofertuar me çmimin 47.2 € qe është çmim ekstrem i ulet. 20 - Motori për hapje me teledirigjim, ku ka ofertuar me çmimin 41.3 € qe është çmim ekstrem i ulet. 15 - betonimi i themeleve shiritore me beton te armuar MB-30, ku ka ofertuar me çmimin 5.90 € qe është çmim "qesharak" ekstrem i ulet. 16 - betonimi me beton te varfër, MB-15, ku ka ofertuar me çmimin 2.36 € qe është çmim "qesharak" ekstrem i ulet. 41 - Furnizim dhe punimi i derës rrëshqitëse, me te gjitha pjesët përcjellëse, ku ka ofertuar me çmimin 17.70 € qe është çmim "qesharak" ekstrem i ulet. 42 - Furnizim dhe punimi i derës, me te gjitha pjesët përcjellëse, ku ka ofertuar me çmimin 17.70 € qe është çmim "qesharak" ekstrem i ulet.

...njëjte vlen edhe për pozicionet tjera te betonit dhe shumicës se pozicioneve tjera te listuara ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, dhe ku çmimet e ofruara nga OE "ARHIKO-ING" O.P ADRIATIKU

janë Jo-Normalisht i Ulëta. Sa i përket pretendimit te OE ankues - Pika 9: AK ka bere shkelje te Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës-paragrafi 3 sipas te cilit thuhet: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim" AK neve na ka eliminuar për kritere te reja- profatura nga palët e treta- te cilat AK i ka vendosur si kritere gjate vlerësimit dhe nuk i ka caktuar ne dosjen e tenderit. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar, pasi qe ne baze te LPP-se, Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, citohet se: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Sa i përket pretendimit te OE ankues - Pika 10: AK ka bere shkelje te Nenit 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregullores për Çmime jo-normalisht te ulet- neni 4.2 ku thuhet qe: "Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja" AK ka kërkuar dokumente shtese profatura te cilat me pare nuk kane qene te caktuara ne dosjen e tenderit. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi qe ne baze te Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht te Ulet, Neni 4 - Procedura e shqyrtimit (inter partes), citohet se: 4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët. 4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Ne baze te kësaj rregullore ka qene e domosdoshme sqarimi ne mes AK dhe OE për çmimet te cilat duket se janë Jo-Normalisht te Ulëta, por sipas paragrafit 4.2 te kësaj rregullore, ky sqarim është dashtë te behet me një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Bazuar ne çka u tha me lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore te OE ankues Grup i OE "Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor" sh.p.k janë te bazuara, dhe ky OE i ka prezantuar tek AK sqarimet e duhura për pozicionet e kontestuara, ka çmime me te arsyetuara, si dhe ne vlerën totale është me çmim me te lirë se sa OE i rekomanduar. Bazuar ne çka u tha me lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore te OE ankues "ARHIKO-ING" O.P janë te pa bazuara, dhe ky OE është i papërgjegjshëm, ka ofruar çmime jo-normalisht te ulëta për shumë pozicione ne ofertën e tij, dhe eliminimi

nga ana e AK është i bazuar, (sa i përket dorëzimit te ofertës vetëm si lider "ARHIKO-ING" O.P dhe jo si konsorcium "ARHIKO-ING" O.P ADRIATIKU – 1 SHPK. kjo te trajtohet nga ana e bordit sa i përket pranueshmërisë nga aspekti administrativ). Bazuar ne çka u tha me lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se OE i rekomanduar Grup i_Operatoreve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH.P.K. është i papërgjegjshëm, ka ofruar çmime Jo-Normalisht te Ulëta, çmime jo reale, ka bere lëvizje artificiale ne mes çmimeve te ngjashme me qellim te përfitimit gjate ekzekutimit te kontratës, e cila si e tillë do te ishte ekonomikisht e pa favorshme për AK. Bazuar ne çka u tha me lartë, AK – KGJK duhet ta Rivlerësoj aktivitetin e prokurimit sipas kritereve te përshkruara ne NJK dhe Dosje te tenderit dhe te respektohet neni 1, 6, 7 dhe 59 i LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues "Çeta-General Invest Group" sh.p.k & "Blenor" sh.p.k të pranohet si e BAZUAR, ndërsa ankesa e OE ankues "ARHIKO-ING" O.P të refuzohet si e PA BAZUAR, rrjedhimisht te anulohet Njoftimi për Dhënie te Kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 03.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarimet nga Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor te Kosovës lidhur me ekspertizën e ekspertit shqyrtues me numër 947/202/953/20, te datës 30/11/2020 Pajtohemi ne tersi me opinionin e dhëne nga eksperti shqyrtues për Grupin Operatoreve Ekonomik; Arhiko ING O.P ADRIATIKU. ku është pajtuar te tersi me te gjeturat ne raportin e vlerësimit dhe te shpallur te pa përgjegjshme ofertën e OE.

Ndërsa. për opinionin e dhëne për pretendimet e Grup i Operatorëve Ekonomik Çeta -General Invest Groupj BLENOR SH.P.K Nuk pajtohem Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor te Kosovës i ka trajtuar të gjithë Operatoret Ekonomik barabarte. konform Ligjit Nr. 04/L-042. për Prokurimin Publik te Republikës Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr, 05/L-092. dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Parimet e Përgjithshme Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, 1. Autoritetet kontraktues. SKGJK-ja, zyra e prokurimit, ka për obligim që të sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; Autoriteti kontraktues, SKGJK-ja, komision i vlerësimit, ka trajtuar operatorët ekonomik, (ofertat) në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues SKGJK-ja, zyra e prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një menyrë që redukton apo

eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose me shume operatoreve ekonomik Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës; Neni 28 Specifikimet teknike. Neni 59 Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Nen 61 Tenderët Jo-Normalisht te Ulet. dhe Rregulloren e nxjerr nga KRPP- B57 Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht. Seksioni II Fleta e te Dhënave te Tenderit (FDT) dhe ne njoftim për kontrate: Sqarim: vlera e parashikuar nga njësia kërkuese departamenti i logjistikes te SKGJK-se, për e kontratës kornize çmimi për njësi për tri (3) vite: 499.999.00€ Katërqind e Nëntëdhjete e Nënte Mije e Nënte qind e Nëntëdhjete e Nënte Euro Kriteri për dhënien e kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët 1 me Poentim Referuar LPP Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, pika 6 RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK Kontratat Kornize NENI 56 15, dhe Udhëzim Administrativ Nr 3/2015: Sipas Peshimit / Rëndësisë qe është dhënë ne Specifikacionin e Listën e çmimeve, Tabelat janë te ndare ne Aneksin 6 Lista e Çmimeve: PER KONTRATEN PUBLIKE KORNIZE - PUNE CMIMI PER NJESI Nivelet (rëndësia) e vlerësimit do te jene ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit. dhe nivelet (niveli 1 me çmim me te ulet ka: 40 pike; niveli 2:me 30 pike; niveli 3 me 20 pike, niveli 4 me 10 pike); Pesha e dhenë secilës nga kriteret (ne % - totali i te gjitha peshave duhet te jete i barabarte me 100 pike) Aneksi 1. SFECTFTKTMET TEKNIKE TË PETYRUESHME - DOSJA E TENPERIT Bazuar LPP, Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, pika 6. dhe RROPP nenit 56 përkatësisht neni 56.15 te RRUOPP-së , edhe pse kjo kontrate është kontrate kornize ne këtë rast nuk vlen pragu apo tavani: plus minus (+ - 30) %, kornizë çmimi për njësi përfundon ne kohëzgjatjes prej 36 muajsh kalendarit nga data e nënshkrimit ne mes AK-se, dhe OE, deri te vlera e parashikuar nga njësia kërkuese departamenti i Logjistikes, vlere e paraqitur ne Njoftim për Kontrate dhe Dosje te Tenderit ne shume totale prej: 499.999 00€, Katërqind e Nëntëdhjete e Nënte Mijë e Nëntëqind e Nëntëdhjete e Nëntë Euro Nënshkrimi i kësaj kontrate publike kornize çmimi për njësi - artikuj nuk e obligon Autoritetin Kontraktues për ti blere artikujt e parapare ne listën e cimeve ne raste kure nuk ka nevoje ne për ato artikuj ne listën e Çmimeve: Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve te gjykatave dhe SKGJK-se Autoritetin Kontraktues, do te paguaj çmim për njësi vetëm për artikujt te cilat te qe kanë nevoje dhe janë te aprovuar nga Aprovuar nga Administratori i Gjykatës, për Gjykatat Themelore P6r degët nga Ndihmës Administratori i Gjykatës; Ndërsa për objekt e SKGJK-se, Menaxher i Kontratës, dhe nga Komisioni i pranimit te punëve te realizuara. Pretendimi i ekspertit shqyrtues Eksperti Shqyrtues konsideron se Autoritetit Kontraktues — Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ne Njoftimi për Kontrate dhe ne Dosje te Tenderit nuk e ka specifikuar çmimin e parashikuar te Poentimit "Tavanin e Poentimit" por vetëm si Kontrate Komike me çmimin c parashikuar te realizimit te punëve: 499,999 00 € për 36 muaj, andaj nuk ka një baze te saktë referuese te çmimeve te ofruara.

Nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues . Sqarim Bazuar Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës. pika 6; dhe Rregullat e Udhëzuesit

Operativ për Prokurim Publik, nenit 56 përkatësisht nenit 56 15 të RRUOPP-së edhe pse kjo kontratë është kontratë kornizë në këtë rast nuk vlen pragu apo tavani: pius. minus (+ - 30 } %. kornizë çmimi për njësi përfundon ne kohëzgjatjes prej 36 muajsh kalendarik nga data e nënshkrimit ne mes AK-se, dhe OE, deri te vlera e parashikuar nga njësia kërkuese departamenti i Logjistikes, vlerë e paraqitur ne Njoftim për Kontrate dhe Dosje te Tenderit ne shumë totale prej: 499.999.006: Katërqind e Nëntëdhjetë e Nëntë Mijë e Nëntëqind e Nëntëdhjetë e Nëntë Euro. Kontratës kornizë Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve te gjykatave dhe SKGJK-se, çmimi për njësi do te realizohet sipas përqindjes te parapare nga njësia kërkuese departamenti i logjistikes SKGJK-se, e cila është e ndare ne Aneksin 6 lista e çmimeve.

Nivelet (rëndësia) e vlerësimit do te jene ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit, dhe nivelet (niveli 1. me çmimin me te ulet ka: 40 pike; niveli 2:me 30 pike; niveli 3:me 20 pike: niveli 4:me 10 pike). Pesha e dhënë secilës nga kriteret (në % - totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100 pike). Pretendimi i ekspertit shqyrtues. Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar dhe AK është dashur qe ti marre parasysh sqarimet e dhëna nga OE ankues ku dëshmohet se për pozicionin nr. 62 çmimi i ofruar nga OE ankues është 250 . 00 €. ndërsa çmimi i OE i rekomanduar është 50.00 € Gjithashtu OE ankues duke i krahasuar çmimet e tija me OE te rekomanduar për pozicionet. nr. 1 19, 120, 121, 122, 123, 124, shihet se ne këto pozicione ka cmime me te larta se sa OE i rekomanduar: Për pozicionin nr. 121 çmimi i OE ankues është 55,00 € ndërsa çmimi i OE te rekomanduar është 30.00 € Për pozicionin nr. 122 çmimi i OE ankues është 85.00 € ndërsa çmimi i OE to rekomanduar është 30.00 €. Për pozicionin nr. 123 çmimi i OE ankues është 100,00 € ndërsa çmimi i OE to rekomanduar është 30.00 €. Për pozicionin nr. 124 çmimi i OE ankues është 120,00 € ndërsa çmimi i OE to rekomanduar është 30.00 €. Nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues . Sqarim Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH P.K, na ka ofruar te gjitha dëshmitë pro faturat te cilat janë te nënshkrua dhe te vulosura. te gjitha janë te nguruaka ne platformën prokurim. Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor Kosovës. nuk është organ hetues ti verifikoj pro faturat te cilat na ka ofruar. Ne rast kontestues për se dëshmitë te cilat na ka ofruar nuk janë dëshmi reale përgjegjësia penale bie direk te Grupi i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH.P.K. KLOKOT, dhe Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor Kosovës, është i gatshëm ne çdo moment te bashkëpunoj me organin ndjekës. Pretendimi i ekspertit shqyrtues Duke pasur parasysh krahasimet ne mes pozicionin numër: 30 (9.00 Euro) dhe pozicionin numër:32 (1.00 Euro) te ofertës te rekomanduar për kontratë. OE. i rekomanduar për kontrate ka ofruar çmime jo reale, ka bere lëvizje artificiale ne mes çmimeve te ngjashme me qellim te përfitimit gjate ekzekutimit te kontratë. Një kontratë e tillë është ekonomikisht e pa favorshme. Nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues . Sqarim Bazuar listës te çmimeve specifikat teknike te nxjerra nga departamenti i logjistikes pozicionet konsiderohet se pozicionin numër: 30, dhe pozicionin numër:32. jane pozicione te ndryshme:

30	Ngjyrosja e murit me ngjyrë yndyrore në dy shtresa. (lloji i ngjyrës përcaktohet nga investitori)	m^2	1

32	Furnizimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve me polikolor- ngjyrë në tri shtresa. (Iloji i ngjyrës përcaktohet nga investitori)	m2 ITI	1 1

Pretendimi i ekspertit shqyrtues . Duke pasur parasysh krahasimet ne mes pozicionin numër: 35 (5.00 Euro) dhe pozicionin numër:30 (9 00 Euro) te ofertës te rekomanduar për kontratë. OE. i rekomanduar për kontrate. E njëjta vlen edhe për pozicionet numër: 193 dhe 61 te kontestuar nga OE ankues ndaj OE i rekomanduar për kontratë. Nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues . Sqarim Specifikat teknike te nxjerra nga departamenti i logjistikes pozicionet konsiderohet se pozicionin numër: 35. Dhe pozicionin numër:30, janë pozicione te ndryshme:

30	Ngjyrosja e murit me ngjyrë yndyrore në dy shtresa. (lloji i ngjyres përcaktohet nga investitori)	m^2	1 1
35	Ngjyrosja e murit me ngjyrë yndyrore në dy shtresa. (lloji i ngjyres përcaktohet nga investitori)	m'	1

	61	Llampa te tipit DOëN LIGHT me poq 26ë per montim ne tavan te rrafshet.(sherben per ndriqim e hyrjes)	copë
	61	Furnizimi me material sl dhe vendosja e olluqeve vertikale nga llamarina e plastifikuar, t = 0,60 mm.	m*
193		Kthes perfundimtare 1/2"	cope
	61	Fumizimi dhe montim Centtral adresibile e zjamt tip PC4020-V3 3 me mundesi te lidhjes me rrjetin telefonik ne rast zjarri	copë

Pretendimi i ekspertit shqyrtues Eksperti Shqyrtues konsideron se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi qe ne baze te Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht te Ulet, Neni 4 - Procedura e shqyrtimit (inter partes). citohet se 41 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ulte ne pajtim me Nenin 61 te LPP dhe

paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille nuk raund te refuzohet pa hetimin dhe shytimin e elementeve te rëndësishme qe shkaktojnë tenderin veçanërisht te ulet 4 2 Ne rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket te jete a normalisht i ulet. Autoriteti Kontraktues duhet te kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin qe duket te jete jo-normalisht i ulte, një deklarate me shkrim e cila përfshinë një zbërthim te detajuar te pjesëve relevant te tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ulte duke përdorur formularin standard te miratuar Ne baze te kësaj rregullore ka qene domosdoshme sqarimi ne mes AK dhe OE për çmimet te elat duket se janë Jo- Normalisht te Ulëta por sipas paragrafit 4 2 te kësaj rregullore, ky sqarim është dashtë te hahet me një deklarate me shkrim e cila përfshinë një zbërthim te detajuar te pjesëve relevant te tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ulte duke përdorur formularin standard te miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tender& jo-normalisht to ulet". Nuk pajtohemi me ekspertizën e eksportit shqyrtues . Sqarim Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor Kosovës i ka trajtuar të gjithë Operatoret Ekonomik barabarte. konform Ligjit Nr 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr 05/L-092 dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Parimet e Përgjithshme Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Autoriteti kontraktues. SKGJK-ja. komisioni i vlerësimit ka trajtuar operatorët ekonomik. (ofertat) ne mënyrë te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe ne mënyrë transparente 2 .Autoriteti kontraktues SKGJK-ja zyra e prokurimit

nuk do te ekzekutojë asnjë aspekt te aktivitetit te prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dem ose ne te mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës.

Neni 28 Specifikimet teknike.

Neni 59 Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht te , dhe Rregulloren e nxjerr nga KRPP- B57 Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht te Ulet.

Pasi qe Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor Kosovës. nuk ka mekanizëm matës te çmimeve te tregut me date: 16/10/2020, ju kemi dërguar konform LPP. nemi 61. te gjithëve operativeve ekonomik pjesëmarrës për ketë aktivitet te prokurimit Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht te ulët. Për pozicionet te cilat keni ofruar tenderët jo-normalisht të ulet, duke ju kërkuar te bashkëngjitën edhe dëshmitë për secilin artikull /pozicion veç e veç. (si dëshmi te gjitha janë të ngarrua ne platforme e-prokurim). DDP, Dudin - Doganës Kosovës, (me te gjitha taksat/tatimet). Ose Pro Faturën / Fature - e Fuqizimit (me te gjitha taksat/tatimet); Dhe pjesën e Fitimit Furnizimit – Shërbimit Informatat e kërkuara duhet te pranohen me shkrim në adresën e larte shënuar te autoritetit kontraktues Deklarata dhe dëshmitë e bashkëngjitura për secilin artikull / pozicion veç e veç lart cekura sipas numrit rendor duhet te ngarkohet ne:

Platforme E- prokurim deri me date: 21.10.2020,ora 16:00. Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e larte shënuara brenda afatit kohor te dhënë. Tenderi juaj do të refuzohet. Pretendimi i ekspertit shqyrtues Bazuar ne çka u tha me larte. Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore te OE ankues Grup i OE "Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor' sh.p.k Janë te bazuara, dhe ky OE i ka prezantuar tek AK sqarimet e duhura për pozicionet e kontestuar. ka çmime me te arsyetuara. si dhe ne vlerën totale është me te lirë se OE i rekomanduar.Nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues . Sqarim Nuk pajtohemi me pretendimin ankimor te Grup i OE "Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor" sh.p.k, dhe te ekspertit shqyrtues. ku pretendon se Grup i OE "Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor" sh.p.k. ka çmim me te lire. Oferta e Grup Operatoreve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; FlorinG SH P K KLOKOT. EO. I rekomanduar për kontratë ne çmim per njesi i Pa Peshuar ne Total eshtë 16,660.40 €. Ndërsa i peshuar ne përqindja sipas tabelave është 4,191.82 €, Oferta e Çeta-General Invest Group" shpk & "Blenor" sh.p.k, ankues ka ofruar ne listës e cimeve ne çmim për njësi i Pa Peshuar ne total është: 25,434.20 €. Ndërsa i peshuar ne përqindja sipas tabelave është: 6, 435.66.

Operatori Ekonomik: "Qeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë,
me datë 02.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Arhiko-Ing" O.P – Prishtinë, me datë 03.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Përshëndetje të nderuar, Nga 11 pika ankimore qe kemi parashtruar ne OSHP, eksperti ka shqyrtuar vetëm gjashte prej tyre ku pikat ankimore 1,3,3 ka konsideruar se janë te bazuara, pikat 8 dhe 9 si te pa bazuara dhe pika 10 pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht ne deklarojmë se pajtohemi pjesërisht me mendimin ekspertit për disa pika, por nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për pikat 8 dhe 9 . Po ashtu nuk pajtohemi me mendimin përfundimtar te ekspertit , cili përkundër qe disa pika i ka vlerësuar si te pa bazuara në fund ka propozuar qe te refuzohet ankesa jone si e pabazuara ne tërësi.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 18.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë procedurës së prokurimit konstaton se AK – KGJK sipas "vlerësimit me poentim" në mënyrë të gabuar ka bërë peshimin e çmimeve të OE- ve pjesëmarrës, sepse sipas shkresave të lëndës AK ka zbatuar rregullat sipas kriterit të dhënies së kontratës "Tenderi i pergjegjeshem me çmimin me te ulët", ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me kriter për dhënie të kontratës "Çmimin më te ulët i poentuar", andaj peshimi i çmimeve nga ana e AK-së në këtë rast, është bërë në mënyrë të gabuar, pasi qe kur AK e vendos si kriter Çmimin më te ulët i poentuar, Paneli shqyrtues nuk hyn ne çmime se a janë jo normalisht te ulet apo jo, pra asnjë OE nuk mund te eliminohen per çmime te pozicioneve pasi qe ato janë te poentuar.

Paneli Shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit lidhur me nenin 61 të LPP-së dhe "Rregullorja për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57)", për këtë pikë pretenduese kemi vendime te OSHP-së te cilët ndër të tjera sqarojnë se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohen praktikat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rast kur kemi krahasimin e çmimeve me ofertat të ndryshme me njëra –tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjen zbatim rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët. Apo, kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga pikët maksimale përcaktohet fituesi, pra te kriteri tenderi me çmim më të lirë të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Në këtë kuptim sqarohet se Rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët gjen zbatim te kriteri "Çmimi më i ulët" por jo edhe te kriteri çmimi më i ulët i poentuar.

Paneli shqyrtues sqaron se ne rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës se dhënë, P.sh nëse pesha është dhënë kategorive te artikujve apo shërbimeve duke u bazuar ne raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj ne mënyrë te qarte se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale te AK-ës. kjo ne baze te interpretimit te KRPP-se te datës 10.12.2019 tek Pyetjet e shpeshta , pyetja nr.62.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ - "Këshilli Gjyqësor i Kosovës",

1x1 / OE/ - "Qeta-General Invest Group"SH.P.K & "Blenor"SH.P.K-Fushë Kosovë,

1x1 /OE/ - "Arhiko-Ing"O.P-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.